



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2230 prot.

Tepelenë, më 08.07. 2026

Njoftim për konsultimin publik

Titulli dhe kodi i projektaktit:

Hartimi i dokumentit të Parë për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029; Hartimi i Paketës Fiskale për vitin 2026.

Takimi publik:

Konsultimet publike do të organizohen sipas kalendarit bashkëlidhur këtij njoftimi.

Të ftuar:

Të gjithë banorët e territorit të Bashkisë Tepelenë, përfaqësues të shoqërisë civile, grupe interesi, bizneset e vogla, OJF, Media, Kryetarët e fshatrave dhe ndërlidhësit komunitarë, grupe vulnerabël, përfaqësues të shoqatës së personave me aftësi të kufizuar etj.

Pjesëmarrës nga bashkia:

Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit Bashkiak, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Memaxhimit Financar, Drejtoria Ligjore dhe Shërbimet Organizative, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e zhvillimit rural, Drejtoria e Arsimit, Sportit dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Administratorët e Njësive Administrative, Sekretarja e Këshillit Bashkiak, Koordinatori për informim dhe Konsultimin Publik, Këshilltarë të Këshillit Bashkiak, kryetarët e fshatrave.

Drejtuesi i takimit publik:

Kryetari i Bashkisë Tepelenë Z.Gramos Sako, Kryetari Këshillit Bashkiak Z.Arben Gumeni



Nr.	Informacioni për publikun	Përshkrim
	Qëllimi i këshillimit publik	Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i ndryshuar, të nenit 18 dhe nenit 54, shkronjat "dh", "e", "f" dhe "k" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak për Konsultimet Publike, Këshilli Bashkiak Tepelenë njofton se do të organizojë seancë këshillimi dhe dëgjimi me publikun për diskutimin e dokumentit: Hartimin e dokumentit të Parë për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029, Diskutimin e Paketës Fiskale 2026 A është komunitetit dakort? Për të sqaruar këtë pyetje këshilli fton komunitetin të jap mendimet dhe sygjerimet me qëllim që çdo vendimarrje të jetë e dakortësuar dhe e favorshme për të gjitha grupet e interesit.
2	Përshkrimi i çështjes që trajton projektakti	Dëgjese me publikun mbi prezantimin e draft dokumentit të parë për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 , Diskutimin e Paketës Fiskale 2026 Gjatë kësaj dëgjese do të bëhet prezantimi i dokumentit të Parë për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 , Diskutimin e Paketës Fiskale 2026, si dhe do të mblidhen rekomandimet dhe sugjerimet nga qytetarët.
3	Projektakti dhe relacionin shoqërues	Materialim i ngarkuar në : https://tepelena.gov.al/projekt-vendime-relacione/
4	Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	A mendoni se prioritetet e parashikuara në këto draft - Projektvendime janë në përputhje me ato që ju konsideroni prioritetet? Cilat janë sugjerimet tuaja për të përmirësuar/ndryshuar këto draft-

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

web: www.tepelena.gov.al E-mail: info@tepelena.gov.al

		projektvendime? Cfarë konsideroni se duhet shtuar në këto draft Projektvendime?
5	Grupet e interesit, strukturat komunitare me të cilat do të konsultohet projektakti	Banorë të Bashkisë Tepelenë, dhe Njësive Administrative.
6	NjA, lagjet, fshatrat ku do të mbahen takimet publike apo që ftohen të dërgojnë komente dhe rekomandime	Bashkia Tepelenë, sipas kalendarit bashkëlidhur.
7	Kalendari i takimeve dhe dëgjësive publike	Kalendari i datave, vendeve dhe orëve është i përcaktuar në kalendarin bashkëlidhur këtij njoftimi. Për cdo lloj komunikimi jeni të lutur të kontaktoni nëpërmjet e-mailit: info@tepelena.gov.al
8	Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve dhe rekomandimeve	1.Komentet dhe rekomandimet tuaja i mirëpresim brenda datës 27/07/2026.
		2. Nëpërmjet pjesëmarrjes tuaj në takimin publik, apo mund t'i dërgoni me e-mail në adresën: Keshilli.Bashkiak@tepelena.gov.al ose info@tepelena.gov.al , ose nëpërmjet postës në adresën: Bashkia Tepelenë, Sheshi "Lord Bajron", Kodi postar 6301
9	Çfarë do të vijojë pas kësaj fazë këshillimi	Pas përfundimit të këtij konsultimi publik, Këshilli Bashkiak do të reflektoj sugjerimet dhe rekomandimet në projektvendimin që do paraqes për miratim në mbledhjen e këshillit bashkiak. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancë të hapur të mbledhje së këshillit.

KALENDARI I ZHVILLIMIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE ME QYTETARËT E BASHKISË TEPELENË

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE	DATA	ORA	VENDI
1	Kurvelesh	28.07.2026	10:00	Qendra e fshatit Progonat
2	Lopës	29.07.2026	10:00	Qendra e fshatit Sinanaj
3	Qëndër – Qytet Tepelenë	30.07.2026	10:00	Pallati Kulturës Tepelenë

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Arben Gumeni

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

web: www.tepelena.gov.al E-mail: info@tepelena.gov.al